

Numri: KSC-BC-2020-06

Prokurori k. Hashim Thaçit, Kadri Veselit, Rexhep Selimit dhe Jakup Krasniqit

Vendosi: Gjykatësi Nikola Giju

Administratore: Dr. Fidelma Donlon

Data: 9 nëntor 2020

Gjuha: Anglishte

Titulli i dosjes: Publike

Klasifikimi: Gjykatësi i Procedurës Paraprake

Kërkesë urgjente për nxjerrjen e një urdhri për të lejuar mbrojtësin e specializuar të marrë pjesë në paraqitjen e parë pa qënë i fizikisht i pranishëm përmes videolidhjes

Prokurorit të Specializuar
Xhek Smith

Mbrojtësit të specializuar për të akuzuarin Kadri Veseli
Ben Emmerson

I. KËRKESË URGJENTE PËR NXJERRJEN E NJË URDHRI PËR TË LEJUAR MBROJTËSIN E SPECIALIZUAR TË MARRË PJESË NË PARAQITJEN E PARË PA QËNË FIZIKISHT I PRANISHËM

1. Më 5 nëntor 2020, Kadri Veseli i'u dorëzua zyrtarëve të Dhomave Speciale të Kosovës, sipas një marrëveshjeje të arritur më herët ndërmjet mbrojtësit të tij dhe stafit të Zyrës së Prokurorit të Specializuar.
2. Më 6 nëntor 2020, Ben Emmerson CBE QC u emërua mbrojtës i specializuar për Kadri Veselin. Me fillim që nga data 9 nëntor 2020, z. Emmerson emëroi Andrew Cayley CMG QC si bashkë-mbrojtës për Kadri Veselin.
3. Më 6 nëntor 2020, Gjykatësi i Procedurës paraprake vendosi të thërrasë një seancë për paraqitjen e parë të z. Veseli, të caktuar për tu mbajtur të martën, më 10 nëntor, në orën 15:00.
4. Parashtruesi i kërkesës kërkon që z. Emmerson të lejohet që të marrë pjesë në këtë seancë nga Mbretëria e Bashkuar pa qënë fizikisht i pranishëm, në mënyrë që të ndihmojë z. Veseli dhe që të paraqesë parashtrimet e nevojshme verbale. Janë marrë masat që z. Cayley të jetë fizikisht i pranishëm në gjykatë për seancën.
5. Arsyeja për këtë kërkesë është sepse z. Emmerson është momentalisht subjekt i një ndalimi për të kryer udhëtime ndërkombëtare, për shkak të kufizimeve operative lidhur me Covid-19 që janë në fuqi në Mbretërinë e Bashkuar. Ky kufizim bazohet në një kërcënim specifik për shëndetin e tij nga Covid-19, si rezultat i një gjendjeje shëndetësore që ka ekzistuar më herët.
6. Në këto rrethana, ne parashtrojmë me respekt se do të ishte e përshtatshme që Gjykatësi i Procedurës Paraprake të autorizonte marrjen e masave të nevojshme për të garantuar përfaqësimin e z. Veseli në paraqitjen e tij të parë nga ana e mbrojtësit të emëruar z. Emmerson, i ndihmuar në gjykatë nga bashkë-mbrojtësi, z. Cayley.

Numri i fjalëve: 343

/nëshkrim/

Ben Emmerson

Mbrojtës i Specializuar për Kadri Veselin

E hënë, 9 nëntor 2020

Hagë, Holandë.